



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0718

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga: Vedat Poterqoi - Kryetar, Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtare dhe Isa Hasani - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) “Harst Group” SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rikonstruimi i shiritave te kembesoreve per rrugën Eqrem Qabej dhe Mobilaret urban per xhepat urban per rrugën Eqrem Qabej” me nr. të prokurimit: "616-23-6430-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Prishtines me datën 27.12.2023, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet, si e pa bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Harst Group” SH.P.K., e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 21.09.2023 (me numër protokollit 718/23) vendimi i AK lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rikonstruimi i shiritave te kembesoreve per rrugën Eqrem Qabej dhe Mobilaret urban per xhepat urban per rrugën Eqrem Qabej “ me nr. të prokurimit: “616-23-6430-5-1-1”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Prishtines, mbetet në fuqi.

2. Meqenëse ankesa e OE ankues është refuzuar si e pabazuar, të njëjtit i konfiskohet tarifa që ka paguar me rastin e parashtrimit të ankesës konform nenit 31 paragrafi 5 i Rregullores së Punës së OSHP-së dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e RKS-së.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 22.06.2023, Komuna e Prishtines, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: “Rikonstruimi i shiritave te kembesoreve per rrugën Eqrem Qabej dhe Mobilaret urban per xhepat urban per rrugën Eqrem Qabej” me nr. të prokurimit: “616-23-6430-5-1-1”.

OE "Harst Group" SH.P.K. me datën 05.09.2023 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. Me datën 12.09.2023, AK- Komuna e Prishtines ,me vendim ka refuzuar si te pa bazuar kërkesat per rishqyrtim.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues "Harst Group" SH.P.K. me datën 21.09.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 718/23, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontratës:Punë, vlera e parashikuar e kontratës: 794.375.85 €.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 25.10.2023 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

Pohimet ankimore të ankuesi dhe përgjigjet e ekspertit shqyrtues

Pretendimi i parë ankimorë ka të bëjë me arsyen e eliminimit të OE ankues, ku sipas AK-së i njëjti nuk ka arritur të ofroj dëshmitë dokumentare të kërkuara në dosje të tenderit mbi qarkullimin e kompanisë në tri vitet e fundit fiskale. OE pretendon se deklaratat e ofruara nga ATK nuk përfshijnë 18% të TVSH-së, dhe se me shtimin e kësaj vlere këtyre raporteve arrihet qarkullimi i kompanisë mbi vlerën e kërkuar në dosje të tenderit. Fillimisht sqarojmë se kërkesa decidive në dosje të tenderit ka qenë :

“1. Operatori ekonomik për LOT 1 duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit fiskale ka qenë prej jo më pak se 1,168,258.00 Euro. (60% Bartësi i konzorciumit)”

Ndërsa dëshmia e kërkuar dokumentare ka qenë :

1. Deklaratat e dorëzuara ne Administratën Tatimore te Kosovës apo Kopjet e raporteve financiare dhe raporteve te menaxhimit te certifikuara nga një firme e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur

Provë: Dosja e tenderit - FDT, pika 8.2&8.2 kërkesa nr.1 Nga dëshmitë e ofruara nga OE ankues - deklaratat e ATK, shihet se nuk arrihet qarkullimi i kërkuar për 1,168,258.00€, në tri vitet e fundit e fundit fiskale. Mendimi i ekspertit është se këtyre raporteve nuk mund të ju shtohet

vlera 18% e TVSH-së apo asnjë vlerë tjetër dhe se raportet e ATK-së duhet të lexohen ashtu si janë, dhe konsiderojmë se shtimi apo heqja e çfarëdo vlere apo të dhëne do të përbënte ndryshim/modifikim të dokumentit. OE po ashtu pretendon se po të llogariten : *qarkullimi prej muajit 08.2020 deri 12.2020- Qarkullimi 215,619.34 € Qarkullimi per vitin 2021 349785.32 € Qarkullimi per vitin 2022 377739.63€ Qarkullimi prej muajit 01.2023 der 07.2023 -Qarkullimi 272784.80€ Totali i qarkullimit prej 1,215.929.09 €*. Megjithatë sipas mendimit tonë kjo do të ishte periudhë me gjatë se tri vite fiskale se ajo e kërkuar (njëkohësisht maksimumi ligjorë i lejuar neni 68 par.1 LPP), pasi do të përfshinte qarkullimin e kompanisë në katër vite fiskale, 1)2020, 2)2021, 3)2022, 4) 2023. Bazuar në gjitha këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar.

Pretendimi tjetër ankimorë është se AK pa të drejtë e ka eliminuar OE ankues për shkak të mungesës së planit dinamik.Sipas OE ankues :

“...Ne piken 12.2 që periudha për programin azhurnues është 15 ditë kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të Projektit, si dhe pika 17.2 Data e përfundimi e të gjitha Punëve do të jetë për Lot 1 prej 120 ditë. Po ashtu kërkesa në DT për planin dinamik nuk ka qenë e precizuar se duhet një plan dinamik i detajuar, apo ndonjë formular të llojit të planit dinamik për të plotësuar siq ka publikuar në kontrata tjera vetë AK formën e planit dinamik që duhet plotësuar...”

Pas analizimit të dosjes së tenderit dhe ofertës së OE ankues, kemi gjetur se plani dinamik është kërkuar në FDT në mënyrë decidive :Dosja e tenderit-FDT OE për LOT 1 dhe LOT 2 duhet të ofrojë planin dinamik për përfundimin e punimeve. Ndërsa në ofertën e OE ankues nuk kemi gjetur prova se OE ka ofruar çfarëdo plani dinamik. OE ankues përmes ankesës në OSHP ka bashkangjitur një plan dinamik, mirëpo sipas mendimit tonë nuk ekziston asnjë mundësi që në mënyrë objektive mund të vërtetohet se ky dokument ka ekzistuar para afatit të fundit për dorëzim të tenderëve siç kërkohet me nenin 72 par.3 të LPP-së.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar.

Pretendimi tjetër ankimor është se për inxhinierin e urbanizimit (arsye e eliminimit të OE), sipas OE ankues AK ka mund të kërkoj sqarime-informata shtesë. OE ankues përmes ankesës ka ofruar informata shtesë si referenca, diploma etj.OE ankues njëjtë ka vepruar edhe për inxhinierin e elektroteknikës edhe pse në ankesë në OSHP mungon pretendimi ankimorë për këtë inxhinier, OE i ka bashkangjitur ankesës dëshmitë për këtë inxhinier dhe po ashtu kjo ka qenë pretendim ankimorë në kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së. Duke pas parasysh se në ankesë në OSHP nga pretendimi 2 OE kalon direkt në pretendimin 4, konsiderojmë se kjo ka mund të ndodhë për shkak të ndonjë gabimi teknik. Sido që të jetë, pavarësisht dëshmimeve të ofruara për stafin (inxh.i Urbanizimit dhe inxh.Elekronteknikës) të cilat kanë mund të sqarohen/plotësohen përmes kërkesës për rishqyrtim, OE ankues nuk ka plotësuar kërkesat për kapacitet ekonomik financiar FDT pika 8.1&8.2 kërksa nr.1, si dhe nuk ka ofruar plan dinamik siç është kërkuar ne FDT pika 9.1&9.2, kërkesa nr.11.

Bazuar në gjitha këto që u cekën më lart, i rekomandojmë panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet e pabazuar, dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesës, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtrësat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor. Në këtë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit, sikurse Ankesat në këtë rast.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktiviteti të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertës shqyrtuese dhe mendimi i saj janë të pranueshme dhe se Paneli me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes pa nevojë që të njëjtat të përsëriten sërish.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurim publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me këtë aktivitet të prokurimit të lartcekur. Sipas të dhënave me sipër eksperti i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues, argumentimi në raportin e ekspertës është mjaft i detajuar i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen këtij aktiviteti të prokurimit. Andaj Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plot të gjendjes faktike duke u mbështetur në LPP si ligj material i zbatueshëm dhe rekomandimin e ekspertës ka gjetur se ankesa duhet të refuzohet si e pa bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur që të vërtetohet Njoftimi mbi vendimin e AK B58 lidhur me anulimin e aktivitetit të prokurimit.

- Përfundim -

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 59 dhe 62 të LPP. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast nuk përbejnë bazë të mjaftueshme që aktiviteti i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktiviteti të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji". Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të

prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - HARST Group SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: